

VENDIM
Nr.22, datë 11.4.2007

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA H/C “EGNATIA”, KOMUNA HOTOLISHT, LIBRAZH, D,
TE “REMI” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11 germa “A” dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 14.10.2004 “Rregullore për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale” neni 9, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Remi” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga H/C “Egnatia”, komuna Hotolisht, Librazhd,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave lidhur me licencimin e “Remi” sh.p.k., për aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga H/C “Egnatia”, komuna Hotolisht, Librazhd.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta